

# **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Artero Pet Cosmetics Albania” shpk,**

Në Tiranë, sot më datë 14.03.2024, unë e poshtëshënuara; Vasilika Hasimi , e datëlindjes 02.07.1953, lindur ne Kosine Përmet dhe banues në Tirane ne adresen Rruga Sali Butka, pallati Cani shpk hyrja 1, Ap 3, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal , F35702095W, me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Artero Pet Cosmetics Albania” shpk.**

**Neni 1.  
Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin **“Artero Pet Cosmetics Albania” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

**Neni 2  
Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

**Neni 3  
Selia**

Shoqëria **“Artero Pet Cosmetics Albania” shpk** e ka seline në adresë: Square 21, Rruga e Kavajes, shkalla Nr 3, Kati perdhe, Njesia 7 Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.


**Neni 4  
Objekti i veprimtarisë**

Objekti i ushtrimit të veprimtarise për shoqërine **“Artero Pet Cosmetics Albania” shpk** është shitje e produkteve kozmetike dhe aksesoreve ndihmes per perkujdesjen dhe mirembajtjen estetike te kafsheve shtepiake .

**Neni 5  
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6  
Kapitali themeltar**



Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë: Vasilika Hasimi , i datëlindjes 02.07.1953, lindur ne Kosine Përmet dhe banues në Tirane,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,F35702095W, zoteron një kuotë ose 100 % të shoqërisë.Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;  
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.  
Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 9 Administrimi**

Administrator i shoqërisë “Artero Pet Cosmetics Albania” shpk është: Vasilika Hasimi, e datëlindjes 02.07.1953, lindur ne Kosine Përmet dhe banuese në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,F35702095W.  
Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 14.03.2024.  
Afati i emërimit te administratorit eshte deri me 14.03.2029.

#### **Neni 10 Baza Ligjore**


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

#### **Neni 11 Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.  
Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare “Artero Pet Cosmetics Albania” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendsur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

#### **ORTAKET THEMELUES**

**Vasilika Hasimi**



Tiranë, më datë 14.03.2024